



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Datë: 23 Maj 2023

NJOFTIM

për operatorët Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/ (Person fizik) që posedojnë leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, për mundësinë e ri licencimit

Duke u bazuar në Rregullorën për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve me numër 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022, përmes së cilës përcaktohet mënyra e kryerjes dhe organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Kryeqytetit dhe Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (ku masa P7 e këtij plani parasheh implementimin e “Përmisimit i të Rregullimit dhe Monitorimit të Shërbimeve të Taksive”, drejtoria e Shërbimeve Publike shpall këtë **“Njoftim për operatorët Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/ (Person fizik) që posedojnë leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, për mundësinë e ri licencimit”**

I. Taksi Kompani (Person juridik) për tu ri licencuar për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

1. Të dëshmojë se është pronar/e i/e veturave me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing) , të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi;
2. Viti i prodhimit të jetë jo më i vjetër se 8 vite për flotën ekzistuese, ndërsa për të rritur flotën deri në 40 (dyzet) vetura, duhet të jenë hibrid dhe/apo elektrik;
3. Vetura duhet të ketë bazën ngjyrë të bardhë;

II. Taksi Individual apo Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët aplikojnë për tu ri licencuar për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

1. Të dëshmojë se është pronar/e i/e veturës me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing) , të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi;
2. viti i prodhimit të jetë jo më i vjetër se 8 vite ose të jetë veturë elektrike/hibride;
3. vetura duhet të ketë bazën ngjyrë të verdhë;

III. Vetura elektrike dhe / apo hibride me të cilën kryhet transporti taksi i udhëtarëve duhet:

1. Të jetë me pesë (4+1) ulëse;
2. të ketë timonin në krahun e majtë dhe të ketë së paku katër (4) dyer;
3. të jetë hibrid dhe/apo elektrik;
4. vetura elektrike duhet të kenë kapacitete të udhëtimit me energji elektrike minimum prej 200 KM, me një mbushje sipas klasifikimit Worldwide Light Duty Vehicles Test Procedure (WLTP);
5. veturat elektrike duhet të kenë kapacitet minimal të baterisë prej 40 kwh.
6. të prezantoj dokumentin COC;

IV. Specifikimi teknik i mbushëseve elektrik duhet të përmbaj këto kërkesa:

1. Kapaciteti i mbushësit DC (niveli 3) në dalje për vetura elektrike duhet të jetë minimalisht 50 KW për njësi dhe të kenë deklaratë të konfirmimit të BE-së (CE certifikatë), EN 61851-23 dhe ISO 15118;
2. mbushësat DC (niveli 3) për vetura elektrike duhet të kenë minimalisht një dalje për mbushje me konektor të llojit CCS2.
Kriteret vetëm për Taksi Kompani (Person juridik) , të cilët aplikojnë për ri licencim me vetura/ë elektrike.

Taksi Kompani (Person juridik) dhe Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët plotësojnë kushtet e lartshënuara do të pajisjen me “Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve” , në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve me mundësi vazhdimi.

Afati maksimal për përshtatjen me kushtet e reja do të jetë gjashtë (6) muaj nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

Vëmendje: Të gjitha përgjegjësit dhe obligimet tjera të ushtrimit të veprimtarisë të transportit taksi, rregullohen sipas Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve duke u bazuar në Rregulloren 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022:

<https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2022/12/7.-Vendim-per-miratimin-e-Rregullores-per-auto-taxi.pdf>